



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit/Opština Lipjan/Municipality of Lipjan

Drejtorati Komunal i Arsimit

Në bazë të Ligjit për arsimin dhe aftësimin e të Rriturve neni 16.1 MASHT. Përkrahur nga Ambasada Norvegjeze në Kosovë përmes OJQ"NOE" dhe në bashkëpunim me SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan

DKA, në Lipjan , Shpall

Konkurs

Për Regjistrimin e 20 (njëzet) vijuesëve nga Komuniteti : RAE , në Programin "Arsimi për të Rritur" për modulet e klasës së X (dhjetë) në SHMP "Adem Gllavica"-Lipjan

Drejtimi: Bujqësi

Profili: Agrobiznes

Kushtet:

Regjistrimin i vijueseve në Programin "Arsimi për të Rritur" bëhet sipas procedurave të njëjta për nxënësit e rregullt , sig është paraparë me Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032.

Në Programin " Arsimi për të Rritur " në shkollat e mesme të larta , vijuesëve ju mundësohet që një vite të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi
[UA nr. 12 /2011 MASHT].të datës : 30.12.2011. neni 4.

Për regjistrim kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryera paraprake
2. Çertifikata e lindjes

Pagesa

Shkollimi në nivelin e Arsimit të mesëm të lartë është me pagesë , participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 11 / 2011 , të datës:30.12.2011 .neni 2.

Shpenzimet e shkollimit për 20 (njëzet) vijues do ta mbështesë Ambasada Norvegjeze në Kosovë , përmes OJQ-së "NOE"

Për këta vijues gjithashtu do të bëhet transporti falas nga shtëpi-shkollë dhe anasjelltas .Gjithashtu këtyre vijueseve do tu paguhet një bursë mujore prej 10 € në muaj gjatë shkollimit.

Pagesat bëhen nga OJQ-ja në gjiro llogarinë e BBK.....
(ceket emri shkollës, vendi dhe qëllimi i pagesës)

Sqarim :Mjetet e krijuara nga participimi do të shpenzohen duke u bazuar në Rregulloren e MASHT-it,në fuqi për grumbullimin dhe shpenzimet e mjeteve nga arsimit jo formal.

Pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

1. Për regjistrim të vitit për një klasë----- 100.00 €
2. Për dhënien e provimeve plotësuese dhe diferenciale me shkrim dhe praktike 10.00 € ndërsa lëndët praktike pa shkrim 8.00 €.
3. Për provimin përfundimtar të klasës, certifikatën----- 30.00 €
4. Pagesa për punën praktike----- 50.00 €
5. Për diplomë të përfundimit të shkollimit.----- 20.00 €

Diplomat që merren në programin "Arsimi dhe Aftësimi për të Rritur" janë të barasvlershëm me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 7 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik, dhe në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit.

Të interesuarit për këtë shkollim, mundë të aplikojnë për çdo ditë pune prej Orës : 8:00 – 16:00 , në shkollën e mesme profesionale " Adem Gllavica " Lipjan.

Datë: 16.09.2015
Nr. 04-610-45639

